



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	07.11.2025	13.11.2025	2025/1081

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.11.2025, OE “Merkatori” SH.A.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1081, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Transport i Tifozeve-Klubeve dhe nevojave tjera te Komunes” me nr. të prokurimit: "651-25-8136-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 75,000.00€. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Operatori Ekonomik Ankues: "Merkatori" SH.A.

Adresa: Rr. Idriz Seferi, p.nr., 60000 Gjilan

Përfaqësuar nga: Jakup V. Berisha, përfaqësues i autorizuar

Tel: 049 125 947

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjilanit

Nr. i prokurimit: 651-25-8136-2-2-1

Titulli i aktivitetit: "Transport i tifozëve – klubeve dhe nevojave tjera të Komunës"

Operatori Ekonomik "Merkatori" SH.A., në cilësinë e ofertuesit pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit të lartcekur, paraqet këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, me të cilin është ndërprerë procedura e prokurimit pas hapjes së dosjeve të ofertave, duke refuzuar në mënyrë të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim.

Gjatë procedurës së hapjes së ofertave, më datë 25.09.2025, ora 14:00 janë paraqitur këto oferta:

- **Merkatori SH.A. – 0.92 €/KM**
- **N.T. Egnatia – 0.94 €/KM**
- **N.T.P. Muhamet A. Hajdari B.I. – 1.50 €/KM**

Sipas kriterëve të dosjes së tenderit, kriter për dhënie të kontratës ka qenë **çmimi më i ulët**. Bazuar në procesverbalin e hapjes, OE "Merkatori" SH.A. ka ofertuar çmimin më të ulët dhe i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka ndërprerë procedurën e prokurimit plot 30 dite pas hapjes, me arsyetimin për mungesë fondesh, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, përkatësisht:

- Nenin 7 – Parimet e përgjithshme të transparencës dhe trajtimit të barabartë;
- Nenin 20.1 – Detyrimin për sigurimin e fondeve buxhetore para fillimit të procedurës së prokurimit;
- Nenin 59 dhe 60 – Dhënia e kontratës sipas kriterit të çmimit më të ulët;
- Nenin 62 – Anulimi i procedurës vetëm për arsye të justifikuara ligjore.

Vendimi i ndërprerjes është marrë pas hapjes së ofertave dhe pa ndonjë dëshmi financiare apo buxhetore që vërteton mungesën e mjeteve. Ky veprim është arbitrar, i paarsyeshëm dhe bie ndesh me frymën e ligjit për prokurim publik.

Duke u bazuar në faktet dhe dispozitat e sipërpërmendura, OE "Merkatori" SH.A. kërkon nga Organit Shqyrtues i Prokurimit (OSHP):

1. Të anulojë vendimin e Komunës së Gjilanit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit me nr. 651-25-8136-2-2-1;
2. Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të rikthejë çështjen në fazën e vlerësimit të ofertave, në përputhje me ligjin;
3. Të konstatojë se veprimet e AK-së kanë cenuar parimet e transparencës dhe konkurrencës së drejtë.

Në pritje të shqyrtimit të drejtë dhe të paanshëm të kësaj ankese ju përshendes.

Me respekt,

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i aktivitetit dhënë nga autoriteti kontraktues: **Transport i Tifozëve-Klubeve dhe nevojave tjera të Komunës**

Nr. i prokurimit ²	651-25-8136-2-2-1
Nr i brendshëm	GI 651 25 143 221

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1	"Merkatori" SH.A., 600008850	0.92 €
2	N.T. " Egnatia ", 600460927	0.94 €
3	Muhamet A. Hajdari B.I., 810370809	1.50 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Autoriteti i Kontraktuar – Kuvendi Komunal Gjiçan, anulon aktivitetin e prokurimit në (paragrafi 1.1.1) të ligjit mbi Prokurimin Publik nr.04/L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligji Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L092 ku sipas: mbështetje Neni 62

B58 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues

Neni 62 Përfundim i Aktivitetit të Prokurimit

- Autoriteti i kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës vetëm për njërin nga arsyet :
 - një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një amendamente ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë dhe rastet ku një dispozite të këtij kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

--

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

--

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

--

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"Merkatori" SH.A.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Kontratë publike kornizë -shërbim. Vlera e parashikuar 75,000.00€. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 20.1, 59, 60 dhe 62 të LPP-së.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se komuna nuk ka mjete të mjaftueshme sipas shkresave të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti, si dhe ZKF-së. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues "Merkatori Sh.A. – Gjilan" pretendon se sipas kriterëve të dosjes së tenderit, kriter për dhënien e kontratës ka qenë çmimi më i ulët, ku OE ankues ka ofertuar me çmimin më të ulët dhe i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Më tej, OE ankues pretendon se AK e ka ndërprerë procedurën e prokurimit 30 ditë pas hapjes së ofertave me arsyetimin për mungesë të fondeve dhe në këtë mënyrë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 20.1, 59, 60 dhe 62 të LPP-së. OE ankues shton se vendimi i AK për anulim është marr pa ndonjë dëshmi financiare që vërteton mungesën e mjeteve, si dhe ky vendim është arbitrar, i paarsyeshëm dhe bie ndesh me frymën e ligjit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 - Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK me rastin e plotësimit të Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve

(27.08.2025) për këtë aktivitet të prokurimit, kishte parashikuar të ndaj 1,000.00 euro për vitin 2025, 50,000.00 euro për vitin 2026 dhe 24,000.00 euro për vitin 2027. Pas plotësimit të kësaj deklarate, AK e kishte publikuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit (05.09.2025), ndërsa kanë ofertuar 3 OE sipas procesverbalit të hapjes së ofertave (25.09.2025), ku OE ankues kishte ofertuar me çmimin më të lirë. Me datë 30.09.2025, Komisioni për vlerësimin e ofertave në raport potencon se 3 ofertat janë të përgjegjshme, mirëpo sipas përgjigjes së njësisë kërkuese dhe ZKF-së, për këtë vit nuk kemi mjete në dispozicion për arsye të vendimeve përmbarimore dhe obligimeve që i kemi pasur, tani nuk mund të sigurohen mjete për vitet vijuese pasi që edhe buxheti nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Komisioni i vlerësimit potencon se këto janë arsyet që rekomandojnë për anulimin e kësaj procedure. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se ky komision ka bashkangjitur një e-mail të Zyrtares Kryesore Financiare të Komunës së Gjilanit, të datës 20.10.2025, në të cilën e-mail theksohet se nuk kanë mjete në dispozicion për arsye të vendimeve përmbarimore dhe obligimeve të cilat i kanë pasur, si dhe nuk mund të bëhet zotimi i mjeteve për shkak të mos aprovimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës. Meqenëse Rregullorja për Prokurim Publik, neni 8, par. 8.5 obligon personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDP që para publikimit të formularit B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDP) nuk kanë ndryshuar, **ekspertja shqyrtuese** konsideron se vazhdimi i këtij aktivitet të prokurimit në mungesë të fondeve mund të qoj në një shkelje të ligjit ashtu siç parashihet në nenin 43.5, pika "i" të Rregullores për prokurim publik.

Sa i përket ankesës së OE ankues, **ekspertja shqyrtuese** konsideron se duke pasur parasysh shpenzimet e ofertimit të cilat krijohen për OE, sikurse sigurimi i tenderit dhe tarifa e ankesës, ankesa duhet ti aprovohet pjesërisht e bazuar OE ankues për shkak se anulimi i procedurës është bërë për shkak të autoritetit kontraktues dhe jo të OE ankues.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"Merkatori" SH.A.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Transport i Tifozëve-Klubeve dhe nevojave tjera të Komunës"** me numër të prokurimit: **"651-25-8136-2-2-1"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"Merkatori" SH.A.**



Majlinda Bedrolli